

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS– kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Vjollca Kurtishaj në çështjen penale kundër të akuzuarit F.J. nga Ferizaji, rr.”Bajram dhe G.S.”, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me ankesën e të dëmtuarës A.D., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.3053/2017 të datës 07.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.09.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të dëmtuarës A.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.3053/2017 të datës 07.06.2018, **vërtetohet**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin P P.nr.3053/2017 të datës 07.06.2018, të akuzuarin F.J., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale. E dëmtuara A.D. nga fshati ..., komuna e Gjakovës është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike. I akuzuari është obliguar që të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30€ si dhe shumën prej 30€ në Fondin e mbrojtjes së viktimave në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e dëmtuara A.D., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me burg efektiv në vend të dënimit me kusht.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.882/2018 me datë 23.08.2018, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarës A.D., të aprovohet pjesërisht dhe atë vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ndërsa, në pjesën tjetër, të hudhet poshtë, si e pa lejuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesa nuk është e bazuar.

E dëmtuara me ankesë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që në të njëjtin nuk janë theksuar shkaqet mbi faktet vendimtare dhe se ekziston kundërthënie në mes të asaj që theksohet lidhur me përmbajtjen e provave dhe se çfarë konkretisht përmbajnë ato prova.

E dëmtuara edhe pse me ankesë ka theksuar se aktgjykimin e shkallës së parë e ankimon edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e njëjta në ankesë nuk ka dhënë asnjë arsye lidhur me pretendimet e saja përkitazi me këto dy baza ankimore.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se, sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPP “ i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjyimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale”.

Në rastin konkret vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPRK, bën pjesë në Kapitullin XVI, në grupin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, pra, bën pjesë në grupin e veprave penale ku të dëmtuarit i lejohet ankesa vetëm ndaj vendimit mbi dënimin, prandaj ankesa përkitazi shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, hudhet si e pa lejuar.

E dëmtuara A.D., në ankesë nuk ka theksuar se aktgjykimin e shkallës së parë e ankimon edhe për shkak të vendimit mbi dënimin mirëpo nga përmbajtja e ankesës rezulton se e njëjta nuk është e kënaqur me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit dhe konsideron se për veprën e kryer ndaj sa, dënimi me kusht është tejte i butë dhe se me një dënim të tillë nuk mund të luftohet dhuna në familje, prandaj i ka propozuar kësaj Gjykate, që të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe ndaj të të akuzuarit të shqiptojë dënim me burg efektiv.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e të dëmtuarës A.D., për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPK-së, me ç’rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar se i njëjti e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, se është i gjendjes së dobët ekonomike, se më parë nuk ka qenë i

dënuar dhe se është penduar për veprën e kryer ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 400 e 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.876/2018 me datë 25.09.2018

Bashkëpunëtorja profesionale
Vjollca Kurtishaj

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Afrim Shala